



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 474/17

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “N.P.N DARDANIA” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së OE “NPN Lindi” - Istog, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumenjve dhe i kanalizimit atmosferik nga puseta në pusetë, me nr.prok:“616/17/4495/521”, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) / Komuna e Prishtinës / më datën 11.01.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik “N.P.N DARDANIA” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumenjve dhe i kanalizimit atmosferik nga puseta në pusetë, me nr.prok:“616/17/4495/521”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues / Komuna e Prishtinës /.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së / Komuna e Prishtinës /, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumenjve dhe i kanalizimit atmosferik nga puseta në pusetë, me nr.prok:“616/17/4495/521”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “N.P.N DARDANIA” - Prishtinë, refuzohet si e pa bazuar i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:28.09.2017.

Hapja e ofertave është bërë me dt:18.10.2017, ku kanë marr pjesë pesë operator ekonomik.

Letra Standarde për operatorin ekonomik të pasuksesshëm është dërguar me dt:14.11.2017.

Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:17.11.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “NPN Lindi” - Istog.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “N.P.N DARDANIA” - Prishtinë, me dt: 21.11.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 24.11.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, “N.P.N DARDANIA” - Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues N.P.N DARDANIA” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 01 dhjetor 2017 me nr. 474/17 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumenjve dhe i kanalizimit atmosferik nga puseta në pusetë, me nr.prok:“616/17/4495/521”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna e Prishtinës” duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 1, 6, 59, dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.12.2017 ka autorizuar ekspertën shqyrtuese profesionale, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja Shqyrtuese profesionale e OSHP-së në raportin e dt: 15.12.2017 ka konstatuar: “Pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues “N.P.N DARDANIA” se ka pasur shkelje të nenit 1, nenit 6 ,nenit 7 ,nenit 59, nenit 60, nga ana e Autoritetit Kontraktue Komuna e Prishtinës në projektin “Pastrimi i shtratit të

lumenjëve dhe i kanalizimit atmosferike nga puseta në pusetë” me nr. te prokurimit: 616/17/4495/521 dhe nr. i brendshëm i prokurimit 616/17/122/521, është i pabazuar. Duke u bazuar ne ankesën e OE ankues “N.P.N DARDANIA” dhe pas shqyrtimit te ofertës se tij shihet se OE ankues nuk ka plotësuar formualrin ne dosjen e tenderit Pjesa C ashtu siq parashihet ne RRUOPP gjegjësisht neni 18 Dosja e Tenderit. Po ashtu bazuar ne Rregullat dhe Udhezuesin Operativ per Prokurim Publik neni 39 Sqarimi i Tenderëve renditja e tabelës e 16-ta me radh ku thuhet citoj “Formulari i Tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon refuzo tenderin pa kërkuar informacione tëmetutjeshme”. Vlenë te theksohet se OE ankues ne nkesën e tij ka pretenduar se nga AK ka pasur shkelje të nenit 6 Ekomociteti dhe Efikasitetit, në këtë pikë të ankesës OE ankues ka deklaruar se OE fitues për dhënie të kontratës është OE me ofertën ne vlerë prej 78,874.50 €, gjë e cila del se nuk qëndron pasi që Autoriteti Kontraktues ne raportin e Vlerësim te Tenderëve dhe ne Nofitimn për Dhënie të Kontrates ka shpallur fitues OE “N.P.N LINDI” me ofertën në vlerë prej 69,844.60 € Bazuar ne konstatimin e lartëcekuratëhere ankesa e OE ankues “N.P.N DARDANIA” është e pabazuar pasi që operatori ekonomik nuk ka plotësuar siç duhet DT dhe nuk ka plotësuar kushtin administrativ të kërkuar sipas RRUOPP . Ekspert profesional i Prokurimit vlerëson si tëPabazuar ankesën e OE “N.p.n Daradania“. Prandaj bazuar në gjitha konstatimet dhe sqarimet e dhënagjatë shqyrtimit të kësaj lënde, eksperti profesional i prokurimit në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon që autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës , tëvazhdoj me proceduart e dhëniessë kontratëspër aktivitetin e prokurimit“Pastrimi i shtrati të lumenjëve dhe i kanalizimit atmosferike nga puseta në pusetë” me nr. prokurimi me nr. te prokurimit: 616/17/4495/521 dhe nr. i brendshëm i prokurimit 616/17/122/521 në përputhje me dispozitat e LPP-sëdhe lëndën e OE ankues ta refuzoj si të Pabazuar”.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 29.12.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 11.01.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti i OSHP-së, vëzhgues nga OJQ D plus, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE z.Gashi deklaroi: “Në sigurimin kemi bërë me atë vlefshmëri, dhe pse kemi harruar të shënojmë atë vlefshmëri me kimik se është ai afat, ne sigurimin e kemi bërë po me atë afat dhe kjo gjendet në dosje”.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK znj.Sekiraqa deklaroi: “AK Prishtinë pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues që aktviteti i prokurimit të vazhdoj me dhënie të kotnratës. Lidhur me pretendimet e OE ankues, neni 38.9 të UOPP formulari duhet plotësuar si duhet, dhe në rast se nuk është plotësuar si duhet apo mugnon duhet elimiuar pa kërkuar sqarime shtesë, andaj kjo është edhe obligim të respektohet nga AK dhe të shpallet administrativisht i papërgjegjshëm.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese znj.Balaj deklaroi: “Unë kam shqyrtuar ankesën dhe kam vërejt se OE nuk ka plotësuar pjesën C nga neni 3 e të posht, nuk ka pas as të dhënat e tij si OE, dhe neni 18 e obligon OE të plotësoj këtë pasi është pjesë kryesor e dosjes. Po ashtu neni 39 i UOPP thotë se në rast se formulari tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mugnon refuzo tenderin pa klërkuar sqarime, dhe kjo është kusht administrativ. OE pretendon se është gabim teknik, mirëpo kjo është gabim i cili kushton dhe nuk mund të kërkohej informata shtesë nëse formulari nuk është plotësuar”.

Në fjalën përfudimtare përfaqësuesi i OE z.Ghashi deklaroi: “Në bazë të eliminimit arsye ka qenë vetëm për shkak periudhës, dhe derisa sigurimi i tenderit ekziston nuk e shoh të arsyeshme të eliminohej. I propozojmë panelit shqyrtues të aprovohet anksa jonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim”.

Në fjalën përfudimtare përfaqësuesi i AK znj.Sekiraqa deklaroi: “Propozojmë që të refuzohet ankesa dhe të vërtetohet vendimi i AK-së”.

Në fjalën përfudimtare eksperti shqyrtues znj.Balaj deklaroi: “Përveq periudhës së vlefshmërisë, OE ankues siq cekta më herët nuk ka plotësuar as pjesën C nga pika 3 e në vazhdim. Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe kosnatimeve të dhëna në raport”.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se është e bazuar arsyeja e eliminimit të OE ankues se ky operator ekonomik nuk ka plotësuar formularin në dosje të tenderit tek pjesa C ashtu siç parashihet tek Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) konkretisht neni tek neni 18.2. Po ashtu bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për

Prokurim Publik neni 39 Sqarimi i Tenderëve renditja e tabelës e 16-ta me radhë thuhet citoj "Formulari i Tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtutjeshme" prandaj bazuar në këto argumente rezulton se arsyeja e eliminimit të OE ankues është e bazuar dhe me të drejtë është shpallur i papërgjegjshëm.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

Duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura, rezulton se operatori ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - "Komuna e Prishtinës"

1x1 OE - "NPN Dardania"- Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Nuhi PAÇARIZI

